

STATUTI

I Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "eTech Solar" shpk

Personat që firmosin si me poshtë:

- Erblin Mehmet Toli, lindur me date 30 Nëntor 1994, Kruje, Shqipëri dhe banues në Tiranë, mbajtes i ID me numer personal J41130007R.
- Elis Demir Malaj, lindur me date 22 Gusht 1993, ne Gostime, Elbasan, Shqipëri dhe banues në Tiranë, mbajtes i ID me numer personal J30822014B
- Ne baze te Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 " Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare ", krijojnë Statutin e Shoqërisë.

KREU 1

Themelimi, Forma, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia.

Neni 1

Data e Themelimit, Forma, dhe Themeluesit.

- (1) Sot me datë 06.10.2021, ne themeluesit, kemi vendosur, të krijojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, sipas Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 " Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare ", dhe aktet e tjera nënligjore qe jane ne fuqi.
- (2) Shoqëria është një person juridik Shqipëtar, i cili do të ushtroje aktivitetin privat ne territorin e Republikës së Shqipërisë, pas regjistrimit ne QKB.
- (3) Themelues te Shoqërisë jane;
 - Erblin Toli, me ID J41130007R, atesia MEHMET, i datëlindjes 30.11.1994, me adrese Nj. Administrative nr 14, Tirane.
 - Elis Malaj, me ID J30822014B, atësia DEMIR, i datëlindjes 22.08.1993, me adrese Nj. Administrative nr 14, Tiranë

Neni 2

Emertimi


Emri i Shoqërisë është " eTech Solar" shpk.


Emri tregëtar i shoqërisë do te jete " eTech Solar",

Neni 3

Objekti

Tregtimi me shumicë dhe pakicë, import-eksporti i materialeve, makinerive, paisjeve dhe impianteve të ndryshme elektrike, Impiante/panelevë fotovoltaike, elektroshtepiake, elektronike, sistemeve/impianeteve termike të ftohjes dhe ngrohjes (kondicionimit), sistemeve për miremanaxhimin e energjisë, sisteme të ndriçimit, sisteme te telekomunikacionit si dhe të impianteve të tjera të ngjashme të destinuara për objekte civile dhe industriale, për sektore të ndryshëm të ekonomisë. Shitja me shumicë dhe pakicë brënda dhe jashtë vendit të materialeve të ndryshme elektrike dhe pajisjeve te tyre te gjitha llojeve te materialeve të tjera industrial, si, impiante ndriçimi, impiante të energjisë alternative, impiante të mbrojtjes nga ngarkesat atmosferike, impiante portash, barrierash dhe impiante kontrollit të dedikuar, impiante kunder grabitjeve, zjarrit, rrezikut nga përmblytjet, gazrat e rrezikshëm, impiante video-vëzhgimi CCTV dhe special, impiante per tranmetim te dhenash, telekomunikacioni etj. Ofrimi i konsulencës

Erblin Toli


Elis Malaj


dhe Asistences Teknike për projektimin, mirëmbajtjen, riparimin, prodhimin e pajisjeve elektrike, fotovoltaike, si dhe të çdo lloj materiali tjetër ndihmës të sistemit dhe rrjetit elektrik. Tregetimi i energjisë nga burime të rinovueshme. Konsulence dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet në fushën e energjisë. Import-eksporti i mallrave e pajisjeve të teknologjive në fushën e energjitikës etj, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e centralit me impiante fotovoltaike e forma të tjera të prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme. Shoqëria përveç sa më lart, mund të kryejë çdo lloj veprimtarie që është në përputhje të Legjislacionin Shqiptar dhe që siguron të ardhura dhe fitime në përputhje me ligjin, brenda kufijve që përcaktohen me ligj, si dhe mund të kryej çdo operacion prodhimi, tregëtar apo financiar që lidhet drejtperdrejtë apo tërthorazi me objektin e saj.

Neni 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë, do të jetë e pakufizuar. Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë me vendim të asamblese së Ortakëve.

Neni 5

Selia

- (1) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën; Rr "Islam ZEKA", Pallati 7, Kati *perdhe*, hyrja 11, Nj. Administrative nr 14, Tirane.
- (2) Adresa e faqes zyrtare të Internetit është: elis.malaj@etech-solar.al
- (3) Adresa e Shoqërisë, për qëllime komunikimi elektronik është si vijon; elis.malaj@etech-solar.al

Neni 6

Shoqëria ka vullen e saj, ku janë të përcaktuara inicialet e emertimit të saj, NIPT-i dhe adresa baze.

KREU II

Kapitali

Neni 7

Kapitali Themeltar

Kapitali fillestar, njekohesisht dhe Kapital Themeltar i Shoqërisë është; 1 000 000 (një milion) leke, i ndarë në dy kuota me vlerë nominale përkatesisht, 500 000 leke njëra kuote dhe 500 000 leke kuota tjetër.

Kapitali Themeltar përbëhet nga Kontribute në vlerë monetare shuma 1 000 000 leke.


Neni 8


Pjesëmarrja e Themeluesve në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë është në përputhje me kontributet e mëposhtme;

- Ortaku Themelues, Erblin TOLI, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme; 500 000 leke, që përbën 50 % të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.
- Ortaku Themelues, Elis MALAJ, zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme; 500 000 leke, që përbën 50 % të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.

Neni 9

Zmadhimi dhe zvogelimi i Kapitalit.

Erblin Toli


Elis Malaj


Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjeseve të Kapitalit Themeltar për kontributet në para dhe kontributet në natyrë, gje e cila arrihet nepermjet emërimit në rrugë ligjore të një eksperti të autorizuar, për keto kontribute sipas kërkeses së paraqitur nga një person i autorizuar nga të gjithë ortakët.

Në asnjë rast, shumica nuk mund të detyroje një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin e Shoqërisë.

Zvogelimi i Kapitalit, lejohet nga Asambleja e Ortakeve, e cila merr vendime në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e Statutit.

Në të gjitha rastet, zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjeseve të kapitalit që përfaqesojnë.

Neni 10

Transferimi i Kapitalit

Kuotat e Kapitalit në një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen, apo kalohen nëpërmjet;

- a. Kontributit në kapitalin e Shoqërisë
- b. Shitblerjes
- c. Trashëgimisë
- d. Dhurimit
- e. Çdo mënyrë tjetër e parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar, janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në Statut.

Pjesët e Kapitalit Themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

KREU III

Organet vendimarrëse dhe drejtuese

Neni 11


Organet Vendimarrëse


Asambleja e Ortakeve, është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve, është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të Statutit, sipas modaliteteve të përcaktuara me ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme;

- Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë.
- Ndryshimet e Statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe Eksperteve Kontabel të Autorizuar.
- Përcaktimin e shpërblimeve për Administratoret, Likujduesit dhe Ekspertet Kontabel të Autorizuar.
- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë edhe paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve për ecurinë e veprimtarisë.
- Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit.
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Përfaqesimin e Shoqërisë në Gjykatë të të gjitha niveleve si dhe në procedimet e tjera ndaj Administratoreve

Abliu Toli


Elis Malcaj


- Perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me Organet e Qeverisjes Qendrore dhe Lokale.
- Riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.
- Miratimin e rregullave procediriale per thirrjen dhe zhvillimin e Mbledhjeve te Asamblese se Ortakeve.
- Çështje te tjera te parashikuara nga ligji apo nga Statuti.

Një Ortak mund të perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve, ne baze te nje autorizimi, nga nje Ortak Tjeter, apo nje person i tretë.

Administratori i Shoqerise (në rastin kur nuk eshte Ortak), nuk mund të veproje si perfaqesues i ortakeve ne Asamblene e Pergjithshme.

Autorizimi i përfaqësimit mund te jepet vetem për nje mbledhje asambleje te pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 12

Mënyra e thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve

- (1) Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet njoftimit me shkresë ose, nëse parashikohet nga Statuti, me njoftim nëpërmjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese, apo me mesazh elektronik duhet te permbaje; vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites. Ky njoftim duhet t'u dergohet te gjithë ortakeve jo me vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese.
- (2) Kur Asambleja e Pergjithshme nuk është thirrur sipas pikes 1 te këtij neni, ajo mund të marre vendime të vlefshme vetem nëse te gjithë ortaket jane dakort, për të marre vendime pavarsisht parregullsisë.

Neni 13

Kuorumi

- (1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 (tridhete) per qind te kuotave.
- (2) Ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendose per çështje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87, te ligjit " Për tregetaret dhe Shoqerite tregetare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numerit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese,apo mjete elektronike,sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.
- (3) Nese Asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te përmendur me lart,asambleja mblidhet perseri jo me vonë se 30 dite,me te njejtin rend dite.


Neni 14


Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakeve pjesemarres, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicene votave te ortakeve pjesemarres,per ceshtje te tjera si:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,

Edlin Pol


Elis Malceaj


- c) Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te experteve kontabel te autorizuar,
 - d) Percaktimin e shperblimeve,
 - e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
 - f) Përfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
 - g) Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese,
- Cdo ndryshim statute duhet t e depozitohet ne QKR duke pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 15

Perjashtimi nga e drejta e votes

1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:
 - a) Vleresimin e vperimtarise se tij,
 - b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij,
 - c) Ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria,
 - d) Dhënjen ose jo te perfitimeve te reja.
2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues I autorizuar, I autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si edhe ortaku qe perfaqeson.

Neni 16

Administrimi

- (1) Asambleja e pergjithshme emerom nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati I emerimit eshte 5 vjet, me te drejte ripertertje. Emerimi I administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- (2) Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar anasjelltas. Cdo emerim I bere ne kundershtrim me keto dispozita eshte I pavlefshem.
- (3) Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se pergjithshme.

Te dhenat e identifikimit:

(mbiemrat, emrat, adresat)

dhe specifikimet e nenshkrimet:

___ Elis MALAJ _____ me ID J30822014B _____

Atesia; DEMIR,

Datelindja: 22.08.1993, me adrese Nj. Administrative nr 14, Tirane.

Neni 17

Kompetencat e Administratoreve


Administratoret kane te drejte dhe detyrohen të:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te Shoqërise, doke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme.
- b) Përfaqesojne Shoqerine tregetare.
- c) Kujdesen për mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise.

Erblin Toli



Elis Malaj



- d) Përgatisin dhe nenshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së përgjithshme për miratim.
- e) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kercenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë.
- f) Kryejnë regjistrimet dhe dergojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin për Qëndren Kombëtare të Regjistrimit.
- g) Raportojnë përpara asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë tregtare.
- h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara me ligj dhe me statut.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblesë të Përgjithshme në rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 10 % të asetëve të Shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- Shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 10 % të asetëve të Shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme, mund të shkërtojë administratorin, në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padite që lidhen me shpërblimin e Administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore të punës, rregullohen sipas dispozitave ligjore në Fuqi.

Neni 18

Përgjegjësia e administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj Shoqërisë ose ndaj të tjerëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për fajet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja, që i sjellin dem Shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe Ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat ekonomike perkatëse.

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të ligjit "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet;
 - a. Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara me ligj dhe me statut, me mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis.
 - b. Të ushtrojë kompetencat që i njohën me ligj dhe me Statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita.
 - c. Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim.
 - d. Të parandalojë dhe menjëherë rastet e konfliktit, prezent, apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë.
 - e. Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

Eubli Tolo



Elis Malcej



2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj Shoqerise per çdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise Tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer me mirebesim.
3. Nese, Administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni, eshte I detyruar t'i demshperbleje Shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal, qe ata apo, personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt, e sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.
4. Në mënyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte I detyruar t'i demshperbleje Shoqerise demet e shkaktuara nese, ne kundershtim me dispozitat e Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 " Për Tregëtarët dhe Shoqerite Tregëtare ", kryen veprimet e meposhtme:
 - U kthen ortakeve kontributet
 - U paguan ortakeve interesa apo dividente
 - U shperndan aktivet e Shoqerise
 - Lejon qe Shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare kur ne baze te gjendjes financiare, duhet te parashikohej qe Shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet.
 - Jep hua.Perveç padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit,ortaket individualisht ose se bashku,kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit. Paditesit kane te drejte te njekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe I eshte shkaktuar shoqerise perfshire edhe demshperblimin financiar,nese eshte e nevojshme.Asnje vendim I asamblese nuk mund te pengoje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU IV

Viti financiar – ekspertet

Neni 19

Viti financiar


Viti financiar i shoqërise fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.


Neni 20

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise,ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille I ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel I autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe ate per kotrollet periodike te

Erblin Toli


Elis Macej


ushtruara, te cilat eshte l detyruar qe tja paraqese e dorezoje ne kohe reale ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 21

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve,
- c) me hapjen e proceduarave te falimentimit,
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"
- e) me vendim te gjykates. Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper". Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga ortaket.

Nese ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 20 diteve kalendarike, pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 22

Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Për Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

Neni 23

Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Kodi Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.


Neni 24

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per vdo mosmarreveshje qe mund te lindre mes Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKET
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"eTECH SOLAR" shpk**

**ORTAKU
Erblin TOLI**

Erblin Toli


**ORTAKU
Elis MALAJ**

Elis Malaj
